

EC. MA

NDRYSH E

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-2119  
Më 12.2.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të nënkryetarit të Komunës, të datës 29.1.2013, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të mbushjeve të telefonisë mobile për vitin 2013, kryetari i Komunës më 12 shkurt 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i nënkryetarit të Komunës, të datës 29.1.2013, për lejimin e mjeteve për pagesë të mbushjeve të telefonisë mobile për vitin 2013, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Sektori i Furnizimit, nënkryetari i Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Sektori i Furnizimit, nënkryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi nga 1 janari 2013.



Kryetari i Komunës  
Ramadan Maja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-1842  
Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës për lejimin e shpalljes së tenderit për servisimin e veturave të tipit Golf VI dhe Caddy, dhe mori këtë

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës për lejimin e servisimit të veturave të tipit VW-Golf VI dhe VW-Caddy, të cilat janë nën garancion të prodhuesit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramazan Muja

The image shows an official circular stamp of the Municipality of Prizren, Kosovo. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVES", "KOMUNA E PRIZRENIT", "Kryetari i Komunës", and "Prof. dr. Ramazan Muja". A handwritten signature in black ink is written over the stamp.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-1842  
Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me material shpenzues për nevojat e Komunës, dhe mori këtë

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës për lejimin e furnizimit me material shpenzues të zyrës për nevojat e Komunës, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-1842  
Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e disa rrugëve lokale në disa fshatra të Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e ndërtimit të disa rrugëve dhe kanalizime në Komunën e Prizrenit. Kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Rrugëve lokale në fshatin Bregdri,
2. Rrugës në fshatin Kojush,
3. Rrugëve dhe kanalizimit në fshatin Krajk,
4. Rrugëve lokale në fshatin Vërmicë.
5. Rrugëve lokale në fshatin Romajë,
6. Rrugëve lokale dhe kanalizimin në fshatin Randobravë, dhe
7. Rrugëve lokale në fshatin Petrovë.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-1842  
Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e disa rrugëve dhe trotuareve sipas planifikimeve buxhetore, dhe mori këtë

### K O N K L U Z I O N


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e ndërtimit të disa rrugëve dhe trotuareve sipas planifikimeve buxhetore të Komunës së Prizrenit. Kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Rrugës Piranë-Reti,
2. Rrugës Dedaj-Rugovë,
3. Rregullimin e trotuareve në rrugët e Arbanës,
4. Zgjerimin dhe ndërtimin e rrugës kryesore për në fshatin Poslisht, dhe
5. Rrugës Krushë e Vogël-Piranë.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-1842  
Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e kanalizimit në fshatin Mazrek dhe Dobrusht, dhe mori këtë

### KONKLuzion


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e ndërtimit të disa kanalizimeve në Komunën e Prizrenit. Kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Kanalizimit në fshatin Mazrek dhe
2. Kanalizimit në fshatin Dobrusht.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-1842  
Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, të datës 5.2.2013, për lejimin e shpalljes së tenderit për punimin e terrenit sportiv në ShFMU "Lidhja e Prizrenit", dhe mori këtë:

### KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 5.2.2013, për lejimin e punimit të terrenit sportiv në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë "Lidhja e Prizrenit", kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës,  
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows an official circular stamp of the Municipality of Prizren, Kosovo. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E PRIZRENIT", "Kryetari i Komunës", and "Prof. dr. Ramadan Muja". A handwritten signature in black ink is written over the stamp.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-1842  
Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, të datës 5.2.2013, për lejimin e shpalljes së tenderit për instalimin e ngrohjes qendrore në ShFMU “Heronjtë e Lumës” në Vërmicë, dhe mori këtë:

### KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 5.2.2013, për lejimin e instalimit të ngrohjes qendrore në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë “Heronjtë e Lumës” në Vërmicë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows an official circular stamp of the Municipality of Prizren, Kosovo. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E PRIZRENIT", "Kryetari i Komunës", and "Prof. dr. Ramadan Muja". A handwritten signature is written over the stamp.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-1842  
Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, të datës 5.2.2013, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me material shpenzues dhe ndërtimor për ushtrimin e punës praktike për ShMT “11 Marsi”, dhe mori këtë:

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 5.2.2013, për lejimin e furnizimit me material shpenzues, ndërtimor, elektroinstalues, ngrohje dhe klimatizim dhe ujësjellës e kanalizim për ushtrimin e punës praktike për Shkollën e Mesme Teknike “11 Marsi”, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramëdan Muja

The image shows an official circular stamp of the Municipality of Prizren, Kosovo. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E PRIZRENIT", "Kryetari i Komunës", "Prof. dr. Ramëdan Muja", and "PRIZREN". A handwritten signature is written over the stamp. To the right of the stamp, there is a handwritten number "1" and a diagonal line.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-1842  
Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, të datës 5.2.2013, për lejimit të shpalljes së tenderit për furnizim me inventarë shkollor për vitin 2013, dhe mori këtë:

### KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 5.2.2013, për lejimin e furnizimit me inventar shkollor për vitin 2013 (banka, karrige, tabela të zeza, etj), kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. C. Madan Mulla



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-1842  
Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, të datës 5.2.2013, për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin dhe ndërtimin e dy klasave për mësim në ShFMU "Mushnikova" në fshatin Drajçiq, dhe mori këtë:

### KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 5.2.2013, për lejimin e hartimit të projektit për ndërtimin e dy klasave për mësim në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë "Mushnikova" në fshatin Drajçiq-faza e parë, dhe ndërtimin e këtyre dy klasave pas hartimit të projektit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-1842  
Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit dhe ndërtimin e banesave për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së, dhe mori këtë:

### KONKLUZION


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i datës 6.2.2013, për lejimin e hartimit të projektit për ndërtimin e banesave për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së dhe ndërtimin e këtyre banesave pas hartimit të projektit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-1842  
Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Inspektorateve të datës 5.2.2013, për lejimin e shpalljes së tenderit për rrënimin e ndërtimeve pa leje në territorin e Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë

### KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Inspektorateve, i datës 5.2.2013, për lejimin e rrënimin të ndërtimeve pa leje dhe punimeve të tjera në territorin e Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Inspektorateve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Inspektorateve, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-2121  
Më 12.2.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të komisionit (ekspertëve) të jashtëm lidhur me punën e bërë në Sistemin e unifikuar të adresave, kryetari i Komunës më 12 shkurt 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Lejohen mjetet financiare për pagesë të komisionit (ekspertëve) të jashtëm në përbërje: Njomza Rizanaj, Besart Osmani dhe Shkumbin Lutfiu, të cilët kanë kryer shërbime të veçanta për Komunën e Prizrenit, lidhur me projektin që ka të bëjë me regjistrimin e adresave në sistemin e unifikuar të adresave.

Anëtarëve të Komisioni (ekspertëve) në emër të punëve të kryera ju lejohen mjetet për pagesë dhe atë për:

1. Njomza Rizanajn lejohen mjetet në shumën 600 €,
2. Besart Osmanin, lejohen mjetet në shumën 600 € dhe
3. Shkumbin Lutfiun, lejohen mjetet në shumën 600 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-2122  
Më 12.2.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për mbështetje me mjete financiare për Javorka Nedelkoviç, me qëllim të furnizimit me gjëra ushqimore (miell), kryetari i Komunës më 12 shkurt 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim për mbështetje me mjete financiare për Javorka Nedelkoviç, nga fshati Smaq, me qëllim të furnizimit me gjëra ushqimore (miell), kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare për furnizim me 500 kg miell.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-2123  
Më 12.2.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Serbi dhe pagesës së shpenzimeve të akomodimit, ushqimit dhe pagesës së mëditjeve për Ajradin Alija dhe Igballka Ramën, kryetari i Komunës, më 12 shkurt 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejitimin e udhëtimit zyrtar të Ajradin Alijes dhe Igballka Ramës për pjesëmarrjen në vizitën e quajtur "Shko dhe Informohu", me qëllim të takimit me personat e zhvendosur të komuniteti serb nga Komuna e Prizrenit, që aktualisht qëndrojnë në Serbi. Vizita do të realizohet nga data 4 mars deri me 7 mars 2013 në disa qytete të Serbisë, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe mbulimi i shpenzimeve të akomodimit, ushqimit dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

### Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.





REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-1842

Më 12.2.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12.2.2013 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik për lejimin e shpalljes së tenderit për rehabilitimin e rrugës për në Kalanë e Korishës-faza e parë, dhe mori këtë

### KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik për lejimin e rehabilitimit të rrugës turistike në Kalanë e Korishës-faza e parë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Mija



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-2124  
Më 12.2.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik për formimin e Komisionit për identifikimin e objekteve në Qendrën Historike të Prizrenit, të cilat kanë nevojë për rehabilitim të fasadave, kryetari i Komunës, me 12 shkurt 2013, mori këtë

## A K T V E N D I M

I. Formohet dhe emërohet Komisioni për identifikimin e objekteve që gjenden në Qendrën Historike të Prizrenit, të cilat kanë nevojë për rehabilitim të fasadave. Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

- a. Bajram Basha, nga DTZHE,
- b. Refki Muzbegu, nga DUPH
- c. Gursel Skenderi, nga Prona
- d. Urim Ukimeri nga DKRS dhe,
- e. Një përfaqësues nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren.


II. Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi do ta bëjë verifikimin, evidentimin dhe analizimin e të gjitha objekteve (shtëpive) që gjenden në Qendrën Historike të Prizrenit, të cilat kanë nevojë për rehabilitim të fasadave dhe, pas verifikimit dhe analizimit, të propozojë me shkrim rehabilitimin e fasadave të objekteve konkrete.

III. Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, si dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, të emëruarit dhe Arkivi.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadas Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-2125  
Më 12.2.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Bruksel të Belgjikës dhe pagesës së mëditjeve për Alban Susurin, zyrtar në Zyrën e Prokurimit, kryetari i Komunës, më 12 shkurt 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejin e udhëtimit zyrtar të zyrtarit në Zyrën e Prokurimit të Komunës së Prizrenit, Alban Susurit, me qëllim të pjesëmarrjes në takimin që ka të bëjë me legjislacionin e BE-së mbi prokurimin publik të autoriteteve lokale dhe rajonale që vijnë nga Ballkani Përendimor. Takimi do të mbahet nga data 19 shkurt deri me 23 shkurt 2013 në Bruksel të Belgjikës, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



